



01/Nr. 4250/2019
Data: 13.05.2019

**PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**

Nga mbledhja e katër -IV- për vitin 2019 e Komitetit për Politik dhe Financa, mbajtur me datë 16.04.2019 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: Rufki Suma (Kryetar i Komunës), Menduh Vlasi (Drejtor për Arsim Kulturë, Rini dhe Sport), Nexhmedin Daci (Drejtor për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), Refet Kalisi (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), Shabi Rexhallari (Drejtor për Buxhet dhe Financa), Kujtim Dernjani (Kryesues i Komisionit të Aksionarëve), Përfaqësuesi i OSB-së. Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politik dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2019.
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për "Javën Kulturore" 2019.
4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënien e pëlqimit për sh.p.k "Elkon" Prishtinë.
5. Informatë për ndarjen e bursave.
6. Informatë mbi raportin financiar për tre mujorin e N.P.L "Pastrimi" Sh.a.
7. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- përveç këtyre pikave të rendit të punës të cilat janë dërguar me agjendë ekzekutivi ka kërkuar që të diskutohen edhe dy pika shtesë për këtë mbledhje. Shqyrtimi i nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën e Kaçanikut. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarje të parcelës për ndërtimin e qendrës kulturore në Han të Elezit. Lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim.

Nuriman Kuka thekson:- i përgëzoj të gjithë ata që ka dhënë kontributin deri tash në Komitet për Politik e Financa por edhe ne duhet të kontribuojmë dhe ta bëjmë një punë të mirë. Është mirë që si anëtarë të Komitetit për Politik e Financa të gjejmë gjuhë të përbashkët për t'i kaluar çështjet të cilat janë me interes për komunën.

Rufki Suma thekson:- pika e parë ka të bëjë me një projekt ndër komunal për shkak se Ministria e Pushtetit Lokal e ka përcjellë një shkresë që komunat me aplikuar për projektin në fjalë. Afati i dorëzimit të projektit është deri me datë 22.04.2019 në mënyrë që me u zotuar që ne do ta miratojmë në kuvendin e komunës. Kemi planifikuar që me hap rrugën Gorancë-Kotlinë përmes këtij bashkëpunimi ndër komunal. Në kuadër të marrëveshjes të cilën e kemi nënshkruar me Ministrinë e Kulturës dhe kanë dërguar një shkresë me të cilën kërkojnë që në kuvend të merret vendim që prona të dedikohet për qendrën kulturore në Han të Elezit por bëhet fjalë për të njëjtin vend.

Mehmet Ballazhi thekson:- të bashkëpunimi ndër komunal është mirë që me pas një bashkëpunim të përgjithshëm, e jo vetëm për projekte të caktuar. Projektin për ndërtimin e qendrës kulturore përfshinë më shumë objektet përcjellëse të shtëpisë kulturore si ndërtesë dhe brenda sajë mendoj që duhet të ketë një muze për shkak se kemi materiale të mjaftueshme edhe pse është histori pak më e re. Ju e dini që në shtëpi të kulturës janë pak diç mbetje të luftës të cilat janë më shumë individuale por është mirë të ketë më shumë pavarësisht se si do ta quajmë ndoshta mund të jetë muze etnografik që është një histori e trashëgimisë së Hanit të Elezit që besoj që ka. Për pikat e rendit të punës të cilat janë përcjell me agjendë nuk kam ndonjë vërejtje.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për pikat shtesë nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri, në tërësi e hedh në votim rendin e punës; rezultati i votimit ishte njëzëri. (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET RENDI I PUNËS

Procedojmë me këtë rend të punës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2019.
3. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për "Javën Kulturore" 2019.
4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënie të pëlqimit për sh.p.k "Elkon" Prishtinë.
5. Informatë për ndarjen e bursave.
6. Informatë mbi raportin financiar për tre mujin e N.P.L "Pastrimi" Sh.a.
7. Shqyrtimi i nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën e Kaçanikut.
8. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarje të parcelës për ndërtimin e qendrës kulturore në Han të Elezit.
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutim, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e komitetit për politik dhe financa).

MIRATOHET PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar – Mars 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Shabi Rexhallari thekson:- buxheti i komunës së Hanit të Elezit për vitin 2019 është në lartësi prej 2,915,921.00 Euro. Ky buxhet është ndarë sipas kategorive ekonomike si në vijim: Paga dhe mëditje 1,493,148.00 €, Mallra dhe shërbime 263,236.00 €, Shpenzime komunale 54,400.00 €, Subvencione dhe transfere 61,104.00 € dhe Shpenzime kapitale 1,044,033.00 €. Totali i buxhetit 2,915,921.00 €. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë janar-mars 2019 është në shumë prej 419,767.06 € apo 14.40 %. Prej tyre për paga dhe mëditje janë shpenzuar 364,197.27 € apo 24.39 %, në mallra dhe shërbime 37,810.39 € apo 14.36 %, në shpenzime komunale 10,532.40 € apo 19.36 %, në subvencione dhe transfere 7,227.00 € apo 11.83 % dhe në shpenzime kapitale 00.00 € apo 0 %. Të hyrat vetanake për këtë periudhë tremujore 2019 janë realizuar në shumë prej 44,588.27 € apo për 4,193.85 € më pak se në periudhën e njëjtë të vitit 2018. Shpenzimi për këtë periudhë tremujore 2019 është realizuar në shumë prej 419,767.06 € apo për 11,277,08 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- në cilat fusha në periudhën e njëjtë me vitin e kaluar ka shpenzime më pak dhe pse shpenzimet janë më të mëdha se në periudhën e njëjtë të viti të kaluar?

Shabi Rexhallari thekson:- vetëm në investimet kapitale është më i vogël në krahasim me periudhën e njëjtë. Vitin e kaluar kemi shpenzuar 10 000 € për këtë periudhë , kurse në këtë vit është zero për këtë periudhë për shkak se buxheti është miratuar me vonesë. Alokimi i mjeteve financiare për investimet kapitale ka filluar në muajin mars dhe procedurat e tenderimit marrin kohë. Në paga kemi shpenzime pak më tepër, në mallra dhe shërbime, shpenzime komunale , subvencione , kurse në investime kapitale kemi më pak. Te pagat shpenzimi është më i madh për shkak se e kanë rritur përvojën e punës për dy vite dhe në arsim ka pas lehonit të cilat janë paguar. Në fund të raportit vjetor të cilin e kemi pasur i kemi paraqitur edhe obligimet të cilat i kemi pasur për vitin 2018 të cilat i kemi paguar dhe për atë është kjo rritje.

Teuta Shkreta thekson:- a ka inventarë rezervë komuna nëpër drejtoritë përkatëse?

Nora Xhoni thekson:- është shënuar ndërtimi i hallës së sportit por kërkojë sqarim. Rregullimi i shtratit të lumit Lepenc a do të hynë në planifikim në këtë vit?

Shabi Rexhallari thekson:- sa i përket rezervave në inventarë secila drejtori e dinë sa ka por me sa jam i informuar në komunë nuk ka inventarë Drejtoria e Shëndetësisë kurse për ambulantë nuk kam informacione.

Rufki Suma thekson:- për vitin 2019 në planifikim e kemi ndërtimin e sallës së sporteve në fshatin Gorancë dhe në Paldenicë por hallën e sportit e kemi lënë për në qytet e cila planifikohet të ndërtohet te pronat e ish armatës.

Nora Xhoni thekson:- është mirë që të precizohet se ku planifikohet me u ndërtuar halla sportive.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA RAPORTI I SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUDHËN JANAR – MARS 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare për "Javën Kulturore" 2019.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- në këtë vit e kemi shpejtuar më herët për shkak të procedurave të prokurimit. Shumën e mjeteve e kemi shtuar dhe janë të specifikuara në detale. Në këtë vit kam planifikuar takim me diasporën. Shuma e përgjithshme që është planifikuar është 8,202.75 €.

Nuriman Kuka thekson:- mjetet financiare të cilat shpenzohen a kthehen në drejtori të arsimit apo me ndonjë drejtori tjetër?

Menduh Vlasi thekson:- mjetet e pa shpenzuar mbeten në Drejtori të Arsimit dhe do të raportojmë për shpenzimet e javës kulturore.

Mehmet Ballazhi thekson:- për shpenzimet për javën kulturore kemi diskutuar që me planifikuar buxhet për kulturë për tërë vitin. U përmendë diaspora dhe manifestimet e dëshmorëve që nëse planifikohet që me u bërë brenda viti nuk është e nevojshme me u bërë planifikim i veçantë.

Menduh Vlasi thekson:- në momentin që kam ardhur në Drejtori të Arsimit kështu e kam gjetur dhe vetë titulli "Javë Kulturore" nuk i përshtatet për arsye se për çdo vit i kemi pasur dhjetë ditë e jo një javë. Unë mendoj që në të ardhmen të jetë ditët e kulturës në komunën e Hanit të Elezit. Buxheti është miratuar një herë dhe kjo çështje po miratohet për së dyti, mirëpo po duam të jemi më transparentë.

Mehmet Ballazhi thekson:- kur të miratohet buxheti për vitin 2020 është mirë që të planifikohet për kulturë rini dhe sport për tërë vitin dhe drejtoria pastaj vetëm e njofton kuvendin për shpenzime që kanë bërë dhe nuk është e nevojshme me u bërë propozim vendim.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE FINACIARE PËR JAVËN KULTURORE 2019 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Shqyrtimi i kërkesës për dhënie e pëlqimit për sh.p.k “Elkon” Prishtinë.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- kompania “Elkon” nga Prishtina që merret me ndërtimin e mini hidrocentraleve kanë parashtruar kërkesë për hulumtim të hidrocentralit ujorë në miniaturë. Këto hidrocentrale prodhojnë rrymë për 100 shtëpi. Në kërkesë të cilën e kanë parashtruar kanë potencuar se nuk dëmtohet mjedisi. Nëse do të bëhet ndërtimi i këtij hidrocentrali ata kanë premtuar që do ta rregullojnë një fushë të futbollit për Hanin e Elezit . Për mendimin tim këto hidrocentrale janë të mirë sepse nuk janë sikur hidrocentralet të cilat e ndajë ujin përmes gypave.

Mehmet Ballazhi thekson:- në cilën pjesë ata mendojnë me ndërtuar këtë hidrocentral?

Nexhmedin Daci thekson:- ata nuk janë përcaktuar saktësisht por unë mendojë që në atë pjesën ku është kafiteria “Bambi”.

Mehmet Ballazhi thekson:- a i keni shikuar çështjet ligjore sepse shfrytëzimi i ujit është i përcaktuar me ligj se sa mundet me shfrytëzuar. Për mbledhje të kuvendit të komunës është mirë të jetë prezent edhe përfaqësuesi i kësaj kompanie për me dhënë të gjitha informacionet në detale para anëtarëve të kuvendit.

Rufki Suma thekson:- fillimisht ndërtohet një reshëtkë dhe pastaj objekti dhe uji nuk shterret në asnjë pjesë dhe siç potencuan që investimet për këtë projekt janë afërsisht 600 000 €. Është një përparësi sepse vendosë hekura në lumin Lepenc të cilët mund të shërbejnë për ndonjë rast të fatkeqësive për shkak se kemi kërkuar edhe nga Ministria përkatëse një gjë të tillë për shkak se çdo send që bien në ujë ndalet aty. I kam treguar se në planet e tona është me u rregulluar shtrati i lumit Lepenc dhe ka potencuar se atë hapësirë që i bjenë afër hidrocentralit do ta rregullon kompania në fjalë.

Teuta Shkreta thekson:- është mirë që mos të preket pjesa e lumit nga Uji i Thartë deri ku është vendosur treni ““Eksodi 99” të ruhet ajo pjesë mos të dëmtohet.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA KËRKESA PËR DHËNIEN E PËRLQIMIT PËR SH.P.K ELKON PRISHTINË QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Informatë për ndarjen e bursave.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Menduh Vlasi thekson:- janë ndarë 15000 sipas vendimit të kuvendit të komunës që është marrë për ndarjen e bursave. Janë planifikuar të ndahen 30 bursa por në këtë vit kemi pasur më pak kërkesa dhe gjithsejtë ishin 24 kërkesa. Janë shpenzuar 11 500 €. Janë katër studentë të cilët kanë marr nga 75 % të bursës sepse ishin nga dy prej një familje , dhe dy janë që e kanë marr qind për qind për shkak notës së lartë mesatare. Komisioni ka bërë rangimin e studentëve dhe në bazë të rangimit shihet që kemi pasur të drejtë që e kemi bërë plotësim ndryshimin e rregullores për shkak se në bazë të notës janë radhitur. I kam ftuar studentët dhe ua kam plotësuar listën studentëve.

Kryesuesi thekson:- është bërë vendim i duhur që është rritur buxheti për ndarjen e bursave për shkak se për tre mandate vetëm është dashur edhe 5000 € për me mbuluar dhe vendimi është i qëlluar.

Mehmet Ballazhi thekson:- cilat kriteret janë marr për studentët të cilët janë në vitin e parë dhe janë përfitues të bursës.

Menduh Vlasi thekson:-studentët e viti të parë vijnë në konsiderim kur nëse nuk ka studentë të vitit të dytë dhe nëse nuk plotësohet lista me studentë nga viti i dytë e më larët përfitojnë studentët e vitit të parë dhe merret nota mesatare e fakultetit, sukcesi i shkollës së mesme dhe testi i maturës.

Mehmet Ballazhi thekson:- është një shqetësim prej studentëve për shkak se po marrin subvencione prej komunës po kryejnë fakultetet dhe po mbesin në rrugë por komuna po i punëson personat pa fakultet dhe pastaj po i dërgon në fakultet. Shqetësimi i dytë është që mund të konkurojë dhe politizohem dhe nuk na marrin në punë.

Nuriman Kuka thekson:- edhe në kuvend të komunës kam potencuar se z.Menduh Vlasi e njëhë profesionin e arsimit dhe ka mundësi më shumë me punuar. Si janë punët nëpër shkolla se a ka probleme të ndryshme sepse nëse ka problem atëherë duhet t'i zgjidhim bashkërisht. Brenda mundësive që i ka komuna bursat duhet me i rritur për shkak se në qoftë se një student merr bursë me notë mesatare shtatë është student i joni.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA INFORMATA PËR NDARJEN E BURSIVE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Informatë mbi raportin financiar për tre mujorin e N.P.L “Pastrimi” Sh.a.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Kujtim Dernjani thekson:- të hyrat nga shërbimet janë në shumë 19 214,50 €. Të hyrat nga Përmbaruesi janë në shumë 121,08 €. Paraja në bankë nga viti 2018 është në shumë 1 518,10 €. Totali është në shumë 20 853,68. Totali i shpenzimeve për këtë tre mujorë është në shumë 15 427.75 €. Kryeshefi i ri ekzekutiv ka filluar punën me datë 01.04.2019. Kontratat familjare dhe bizneseve për vitin 2019 janë:- Janar 14 kontrata, Shkurt 40 kontrata, Mars 6 kontrata, gjithsej 60 kontrata familjare, ndërsa ato biznese janë bërë 8 kontrata. Ndërmarrja Publike Lokale – N.P.L “Pastrimi” Sh.a, bënë menaxhimin e mbeturinave në komunën e Hanit të Elezit dhe gjithsej ka dymbëdhjetë (12) punëtorë, katër prej të cilëve, Bedri Bushi me numër personal 1012244564 në pozitën e punës (Shofer), Sevdil Shkreta me numër personal 2173308577 punëtorë (Punë Publike), Alban Hasallari me numër personal 1247744122 punëtorë (Punë Publike), Besmir Hasallari me numër personal 1234149110 punëtorë (Punë Publike), janë me kontratë në vepër, gjashtë muaj,

i paguan Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, prej datës 01.03.2019 deri më 31.08.2019. Në tre mujorin e parë të vitit 2019-të janë mbajtur tre mbledhje me Bordin e Drejtorëve mbledhja e parë me datë 31.01.2019, mbledhja e dytë me datë 26.02.2019, mbledhja e tretë me datë 26.03.2019.

Mehmet Ballazhi thekson:- mbledhjet e bordit të cilat janë mbajtur do të ishte mirë me na informuar rreth pikave dhe diskutimeve dhe të kemi një pasqyrë të asaj mbledhje.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA INFORMATA MBI RAPORTIN FINACIAR PËR TRE MUJORIN E N.P.L PASTRIMI SH.A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Shqyrtimi i propozim vendimit për ndarje të parcelës për ndërtimin e qendrës kulturore në Han të Elezit

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- projekti është bashkëfinancim me Ministrinë e Kulturës dhe kërkojnë projektin kryesorë, matjet gjeodezike dhe vendimin prej kuvendit të komunës për ndarje të parcelës.

Nuriman Kuka thekson:- sa ari janë në këtë parcelë dhe a ka mundësi me biseduar me përfaqësuesit e kompanisë “Sharrcem” për me rregulluar më mirë çështjen e parcelës?

Rufki Suma thekson:- do të bisedojmë me përfaqësuesit e kompanisë dhe me disa pronarë privat në mënyrë që me u zgjeruar dhe me bërë drejtë në mënyrë që pjesa përpara me mbetur më e lirë.

Mehmet Ballazhi thekson:- projekti është dashur të realizohet edhe më herët por është mirë të planifikohet muzeu dhe objektet tjera përcjellëse , mirëpo do të ishte mirë që edhe projektin me pa dhe me diskutuar sepse idetë janë të mirëseardhura

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR NDARJEN E PARCELËS PËR NDËRTIMIN E QENDRËS KULTURORE NË HAN TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Shqyrtimi i nismës për bashkëpunim ndër komunal me komunën e Kaçanikut

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Rufki Suma thekson:- duhet të përcaktohet si projekt për shkak se kështu kërkohen për me aplikuar. Nëse keni ndonjë vërejtje mund të parashtroni.

Mehmet Ballazhi thekson:- bashkëpunimi ndër komunal duhet të ishte në fusha të ndryshme dhe mendoj që nuk duhet të jetë afat gjatë por të jetë i përhershëm. Bashkëpunimi ndër komunal duhet të jetë për çdo projekt , për çdo fushë dhe problem për shkak se nuk është vetëm një projekt që ta japim një pëlqim. Më mirë do të ishte bashkëpunimi ndër komunal për projekte të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri (prezent ishin të gjithë anëtarët e Komitetit për Politik dhe Financa).

U VOTUA NISMA PËR BASHKËPUNIM NDËR KOMUNAL ME KOMUNËN E KAÇANIKUT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Mehmet Ballazhi thekson:- duhet të ndërmerret diçka për trajtimin e qenve endacak për shkak se vërejtje kam dhënë edhe më herët që mos të na ndodhë diçka e pastaj me marr masa. Shumë prindër i sjellin fëmijët e tyre në shkollë për shkak të qenve endacak edhe në shkollën fillore “Kështjella e Diturisë” dhe në shkollën fillore “Ilaz Thaçi” në Han të Elezit. Keni potencuar se është çështje e qeverisë por nëse ndodhë diçka kush do të jep përgjegjësi. Fusha e sportit te shkolla e mesme “Dardania” me sa jam i informuar nuk funksionon për shkak të rrezikshmërisë , kërkoj informacion.

Rufki Suma thekson:- për çështjen qenve endacak edhe nëse duam me bërë diçka si komunë nuk mundemi për shkak problemeve me Ligjin dhe problem kemi edhe me Ariun i cili i ka dëmtuar kosheret e bletëve dhe nuk mund të bëjmë zgjidhje për shkak të ligjit. Trajtimin siç e kanë bërë disa komuna nuk mundmi me bërë sepse kanë dështuar dhe vetëm kanë shpenzuar mjete financiare dhe zgjidhje nuk kanë bërë.

Mehmet Ballazhi thekson:- pasi deklaroni që nuk keni kompetenca si ekzekutiv a keni bërë kërkesa dhe ankesa se ka edhe shqetësime ati ku nuk të lejon më shumë me vepruar ti, në mënyrë që të keni dokument që keni bërë kërkesë dhe ankesë për trajtimin e këtyre qenve dhe ju si komunë e hiqni përgjegjësinë prej jush. Është pak më e lehtë kur t’i i ke bërë përpjekjet e tua dhe nëse nuk ta lejon ligji nuk mundesh me dal mbi ligjin.

Rufki Suma thekson:-te fusha e sportit te shkolla e mesme “Dardania” do të bëhet muri dhe do të rregullohet rrethoja dhe fusha do të bëhet funksionale.

Kryesuesi thekson:- a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka shpalli të mbyllur mbledhjen, ju faleminderit për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 12:30

Procesmbajtësi
Avni Bushi

